

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Servis dhe shërbime për automjete”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):
50110000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,150,866.67 (kater milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e teteqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e shtatë) leke pa TVSH.

Kohezgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vore** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. **Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10**

b. **Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

1.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

1.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e cila duhet të jetë Brenda afateve të vlefshmërisë, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktitura dhe për veprimtari që lidhen me to”, i ndryshuar për pikat a, b, c, ç, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Operatori ekonomik duhet të ketë Leje Mjedisi të tipit III.1.B “Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet

Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Ky kriter vendoset mbështetur në Ligjin Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, neni 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, duke siguruar AK që shërbimet objekt prokurimi do të realizohen nga subjekte që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

Liçenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin nr.7, datë 10.01.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 61, pikat 2 dhe 5, i Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), ku citohet:

.....“2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e

vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”.....

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, *(i ndryshuar)*, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” *(i ndryshuar)*, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” *(i ndryshuar)*. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” *(i ndryshuar)*. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvoja të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neneve 41, 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet/furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar në nenin 55 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Pergjegjes Teknik: Inxhinier Mekanik/Teknik Mekanik/Mekanik Transporti;
- b) 1 (një) motorrist;
- c) 1 (një) elektroaut;

Për punonjësit e mësipër ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës
- diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ licënuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”/Deshmi aftësie profesionale sipas nenit 9 pikat 2) 3) e Ligjit nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura dhe per veprimtari qe lidhen me to”, i ndryshuar ose ekuivalente
- te figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën/muajin e fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.2) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipër, emer/mbiemer, profili i punës, te dhenat e kontratës individuale të punës, te dhenat per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Ligjit nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura dhe per veprimtari qe lidhen me to”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Kërkesa për Pergjegjesin Teknik/Inxhinier Mekanik/Teknik Mekanik/Mekanik Transporti është bazuar në pikën 2, neni 6 dhe nenin 9 në Ligjin Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, i ndryshuar i cili ka një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe realizimin e shërbimit, objekt

prokurimi në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit, etj është e nevojshme disponimi i një stafi teknik me profesione si motorist, elektroauto, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kane nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës të cilat duhet të përmbushë gjatë kryerjes së këtij shërbimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin: dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kohezgjatjes së kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.3) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, te dhenat e kontratës individuale të punës, te dhenat për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe ambjentet e duhura për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është shërbimi dhe servisi i automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij.

Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) Operatori ekonomik duhet të disponojë licënsa profesionale për ekzekutimin e shërbimeve dhe duhet të përmbajë specifikimet e mëposhtme:

- Servisi duhet të ketë jo më pak se 1 urë ngritëse për automjetet;
- Pajisje diagnostifikim difekti për automjetet e mësipërme;
- Aparat për regjistrim frenash;
- Aparat për mbushjen me gaz të kondicionuar;
- Linjë testimi elektronike për sistemin e frenimit të mjeteve;
- Pjesët e këmbimit të jenë origjinale dhe shërbimet të jenë me garanci jo më pak se 12 muaj nga data e ndërrimit/ shërbimit;

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.4) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesipër, emer/mbiemer, profili i punës, te dhenat e kontratës individuale të punës, te dhenat për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi. Duke vlerësuar proceset e shërbimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre paisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se ofertuesit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.2) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesipër, emer/mbiemer, profili i punës, te dhenat e kontratës individuale të punës, te dhenat për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 :2015 për sistemin e menaxhimit të cilësive ose ekuivalente, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 :2026 për sistemin e menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 :2018 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikat ISO e kërkuar është e detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të preventivit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të automjeteve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti 14001: 2026 mbi "Sistemet e menaxhimit të mjedisit" – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standarti është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë shërbimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, procese gjatë të cilave përdoren produkte që mund të jenë të dëmshme për mjedisin, si vajrat dhe kimikatat. Paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.

Standarti ISO 45001:2018 mbi "Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga makineritë që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, djegie nga substanca të nxehta, lëndime nga kontaktet me kimikate toksike apo ndotëse, madje edhe ndotje akustike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/a dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin

ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në rast se gjatë hartimit të dokumentave të tenderit dhe kërkesave për kualifikim është përmendur ndonjë markë, operatorët ekonomikë ofertues kanë të drejtë të ofertojnë me ekuivalenten e tyre gjatë hartimit të ofertës ekonomike apo dokumentacionit të nevojshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë.

VLERA E FONDIT LIMIT

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në mbështetje dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar ku parashikohet se: *b)Studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*

NJESIA E PROKURIMIT